

LIGJ
Nr.8316, datë 1.4.1998

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË PAGAVE DHE BUXHETIT PËR
INSPEKTORATIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet e mëvonshme dhe të nenit 18 të ligjit nr.8265, datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Struktura e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga:
Kryeinspektor, zëvendëskryeinspektor, 4 inspektorë gjyqtarë, 2 inspektorë prokurorë dhe 7 punonjës të administratës.

Neni 2

Paga e kryeinspektorit, zëvendëskryeinspektorit dhe inspektorëve gjyqtarë e prokurorë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë njësohen përkatësisht me pagën e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës së Apelit Civil të Tiranës.

Neni 3

Në përcaktimin e pagës së sotme të Inspektoratit merren parasysh indeksimet e bëra sipas nenit 4 të ligjit nr.7800, datë 2.3.1994 “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve”.

Neni 4

Pagat e administratës përcaktohen sipas kriterëve të pagave të administratës së organeve qendrore.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të sigurojë mjediset dhe mjetet e punës për funksionimin e Inspektoratit.

Neni 6

Pagat dhe shpenzimet e tjera buxhetore të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vitin 1998 përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe për pagën e inspektorëve, që kanë filluar punën, i shtrin efektet nga data 1.3.1998.

Shpallur me dekretin nr.2040, datë 9.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

